

# Buletin informativ

## Deklarata Vjetore e të Ardhurave Personale

Afati i dorëzimit: 30 prill 2021



Me afrimin e afatit për dorëzimin e Deklaratës Vjetore të të Ardhurave Personale, dëshirojmë t'ju kujtojmë lidhur me detyrimet dhe modalitetet e dorëzimit të Deklaratës.

### *Çfarë është?*

Deklarata Vjetore e të Ardhurave Personale, është një formular që individët dorëzojnë pranë autoriteteve tatimore shqiptare, me qëllim raportimin e të ardhurave të gjeneruara përgjatë vitit, si dhe llogaritjen dhe pagesën e tatimit përkatës.

Afati për dorëzimin e Deklaratës Vjetore të të Ardhurave Personale për vitin fiskal 2020 është data 30 Prill 2021.

### *Kush preket?*

Bazuar në Ligjin Nr. 8438 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, datë 28.12.1998, individët rezidentë dhe jo-rezidentë, që realizojnë të ardhura vjetore bruto mbi 2 milionë lekë, janë të detyruar të plotësojnë dhe të dorëzojnë Deklaratën Vjetore të të Ardhurave Personale. Për rezidentët Shqiptarë, kufiri prej 2 milionë lekë aplikohet për të ardhurat e realizuara brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, ndërkohë për individët jo-rezidentë, kufiri është i aplikueshëm vetëm për të ardhurat e gjeneruara në Republikën e Shqipërisë.

Deklarata Vjetore e të Ardhurave Personale këtë vit duhet të plotësohet edhe nga të gjithë të dypunësuarit pavarësisht nivelit të të ardhurave bruto që përfitojnë.

Në koherencë me nenin 8 të ligjit të sipërpërmendur, konsiderohet si e ardhur: paga dhe shpërblimet lidhur me punësimin, dividendët, interesat, e drejta e autorit, të ardhurat nga qiraja, të ardhurat nga lojrat e fatit dhe kazinotë, të ardhurat kapitale dhe lloje të tjera të të ardhurave jo të specifikuar në këtë nen.



## Buletin informativ

# Deklarata Vjetore e të Ardhurave Personale

Deklarata Vjetore e të Ardhurave Personale mund të përgatitet dhe të dorëzohet vullnetarisht nga individ të cilët nuk përmbushin kushtin e vendosur për kufirin 2 milionë lekë, në rast se ata duan të përfitojnë nga skema e shpenzimeve të zbritshme, e aplikueshme për disa kategori specifike të të ardhurave.

### *Si mund të përmbush detyrimin për dorëzim?*

Dorëzimi i Deklaratës Individuale Vjetore të të Ardhurave kryhet elektronikisht nëpërmjet sistemit të tatimeve ([eFiling](#)).

Individët të cilët aktualisht kanë një llogari aktive në faqen e përmendur, mund të aksesojnë nëpërmjet saj dhe të plotësojnë elektronikisht formularin për vitin fiskal 2020.

Individët të cilët nuk kanë një llogari aktive, duhet:

- **Për individët Shqiptar** - të regjistrohen në sistemin eFiling (sistemi i tatimeve) dhe krijojnë një adresë nëpërmjet plotësimit të të dhënave personale të kërkuara dhe vendosjes së një fjalëkalimi.
- **Për individët e huaj** - personalisht/ose nëpërmjet përfaqësuesit të tyre, duhet të paraqiten te Drejtoria Rajonale Tatimore dhe të pajisen me një fjalëkalim, i cili do t'i japi mundësinë individit të aksesojë sistemin e tatimeve.

Pas aktivizimit të llogarisë, individët duhet të plotësojnë elektronikisht formularin e kërkuar për vitin fiskal 2020.

### *Çfarë ndodh në rast mospërmbushje të detyrimit për dorëzim?*

Në rast mosdorëzimi të Deklaratës Vjetore të të Ardhurave Personale, individit i aplikohet një gjobë prej 5,000 lekësh.

Individët, të cilët kanë dorëzuar Deklaratën Individuale të të Ardhurave Personale në përputhje me afatin e përcaktuar, mund ta ndryshojnë atë deri në dy herë brenda 3 muajve nga dorëzimi i parë pa penalizim. Korrigjimet e deklaratës pas herës së dytë do t'i nënshtrohen penalteteve përkatëse, në rast se ndryshimet rezultojnë në detyrim tatimor shtesë.

## KONTAKT

Për më shumë detaje për sa më sipër ose lidhur me çështje të tjera në lëmin fiskal, ju lutem referohuni tek:

**Teit GJINI**  
Managing Partner  
teit.gjini@mazars.al

**Erinda XHAFERRAJ**  
Head of Tax Advisory Services  
erinda.xhaferraj@mazars.al